

Instituti për Studime të Avancuara GAP

Letërnjoftimi i Komunës së Shtimes 2013

Janar, 2013

“Letërnjoftimi i Komunave” është projekt i Institutit GAP i cili vlerëson qeverisjen komunale dy vite pas zgjedhjeve lokale të 2009. Ky projekt është implementuar në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe Qendrën e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC). Rezultatet e hulumtimeve të GAP për qeverisjen komunale janë debatuar me kryetarët e komunave në emisionet “Jeta në Kosovë”.

Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive.....	3
1. Problemet në Komunën e Shtimes.....	5
2. Performanca buxhetore e Komunës së Shtimes.....	5
3. Investimet kapitale.....	8
4. Aktivitetet e Prokurimit Publik 2010 - 2011.....	9
5. Administrata e Komunës së Shtimes.....	10
6. Arsimi në Komunën e Shtimes.....	11
7. Shëndetësia në Komunën e Shtimes.....	13
8. Transparenca.....	13
9. Përmbushja e premtimeve të fushatës zgjedhore 2009.....	15
10. Burimet:.....	18

Përmbledhje ekzekutive

Komuna e Shtimes udhëhiqet nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK). Kryetari i kësaj komune z. Naim Ismajli është zgjedhur në mandatin e dytë në zgjedhjet e fundit lokale të mbajtura në fund të vitit 2009. Gjatë periudhës 2001-2007 ai ka qenë kryeshef ekzekutiv i Komunës së Shtimes, pozitë kjo që në atë kohë ka pasur kompetenca të gjëra. PDK udhëheq edhe me Kuvendin Komunal në Shtime. Nga gjithsejtë 21 asambleistë sa numëron Kuvendi Komunal, 10 prej tyre janë nga PDK, pesë nga LDK, dy nga AKR, dy nga LDD dhe me nga një asamblistë përfaqësohet AAK dhe PSD.

Nga regjistrimi i fundit i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave ka rezultuar që komuna e Shtimes ka gjithsejtë 27.324 banorë.¹ Nga shkalla e të hyrave komunale, komuna e Shtimes kategorizohet në mesin e komunave me më se paku të hyrash. Rreth 340.000 euro llogariten të hyrat komunale, shifër kjo që është e përafërt më shumë e të hyrave komunale që ka vjel Hani i Elezit gjatë 2011 e cila ka rreth 18.000 banorë më pak se komuna e Shtimes.²

Komuna e Shtimes në fund të vitit 2012 ka rezultuar me 100.000 euro të hyra financiare më pak se një vit më herët 2011. Kjo paraqet një rënie drastike të të hyrave komunale, që mund të jetë edhe si pasojë e pamundësisë së qytetarëve dhe bizneseve për të kryer obligimet tatimore.

Problemet në këtë komunë nuk janë të pakta, megjithëse nuk ka munguar angazhimi i udhëheqësve komunal në zgjidhjen e tyre. Klubet sportive, si Klubi i Karatesë, Klubi i Boksit, Klubi i Shahut si dhe Klubet e Futbollit të vogël kanë shuar veprimtarin e tyre në Shtime. Kjo ka ardhur nga mungesa e përkrahjes institucionale. Në anën tjetër, Komuna e Shtimes më 19.01.2010 ka ndarë 5.000 euro për t'i ndihmuar familjet e vërshuara nga uji në veri të Shqipërisë.³

Në fshatin Petrovë funksionojë 6 gurthyesh. Banorët e këtij fshati i janë adresuar disa herë komunës për të ndërmarrë masa, por asnjë veprim nuk është ndërmarrë. Fshati në vazhdimësi është i mbuluar nga pluhuri, përderisa banorët ndiejnë një shkallë të lartë të rrezikshmërisë nga shembja e mundshme e shtëpive të tyre.

I gjithë stafi i komunës shkojnë për çdo vit në vizitë në Shqipëri. Këto vizita bëhen në kohën kur Komuna arsyetohet se nuk ka mjete për të shtrirë ndriçimin publik në zonat

¹ Agjencia e Statistikave të Kosovës. Rezultatet përfundimtare për Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave - 2011. Burimi: http://esk.rks.gov.net/rekos2011/repository/docs/Te%20dhenat%20kryesore_ALB.pdf

² Komuna e Hanit të Elezit gjatë 2011 ka pasur të hyra në shumë prej 303.000 euro.

³ Komuna e Shtimes. Faqja zyrtare. Vendimet. Burimi: <http://www.shtime-komuna.org/?mod=mod&id=1&mid=184>

urbane të qytetit. Rruga që të shpie tek gjimnazi “Naim Frashri” nuk ka ndriçim publik. Banorët disa herë kanë kërkuar që së paku kjo rrugë të ndriçohet. Vetëm transporti i stafit administrativ të komunës në Shqipëri i ka kushtuar afro 1.800 euro buxhetit të komunës.⁴

Komuna e Shtimes është njëra nga komunat e pakta në vend që posedon dy faqe zyrtare në internet. Të dy faqet janë funksionale dhe përgjithësisht mbulojnë apo transmetojnë aktivitetet apo agjendën e kryetarit. Në asnjërën uebfaqe nuk mund të hasesh qoftë edhe një raport të vetëm për shpenzimet e parasë publike në tri vitet e fundit. Po ashtu në asnjërën uebfaqe nuk publikohen procesverbalet e mbajtjes së takimeve të rregullta të Kuvendit Komunal. Procesverbali i fundit që mund të haset në këto ueb faqe është ai i vitit 2005.⁵

Përfaqësimi i femrës në pozitat udhëheqëse dhe pozitat tjera përkatëse në Komunën e Shtimes mbetet tejet i vogël. Nga tetë Drejtori sa ka kjo komunë, asnjëra nuk udhëhiqet nga femrat. Numri i përgjithshëm i femrave të punësuar në dikasteret e ndryshme të komunës është tejet i vogël.

Instituti GAP ka vlerësuar ecurinë e përgjithshme të zhvillimeve në këtë komunë. Janë evidentuar dhe numëruar problemet, mangësitë dhe vështirësitë nga fusha e investimeve kapitale, mënyra e shfrytëzimit dhe shpenzimit të parasë publike, shkalla e transparencës, prokurimi publik, funksionimi i administratës dhe po ashtu janë vlerësuar ndaras të gjitha premtimet e dhëna nga Kryetari i Komunës gjatë fushatës zgjedhore të vitit 2009 dhe ecuria e deritanishme e realizimit të tyre.

⁴ Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Njoftimet e shpallura. Burimi: <http://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=ViewNotices&ID=49313>

⁵ Komuna e Shtimes. Web faqja e hapur sipas modelit të MAPL. Burimi: <http://kk.rks-gov.net/shtime/> & Ueb faqja e Komunës së Shtimes e hapur nga Komuna e Shtimes. Burimi: <http://www.shtime-komuna.org/index.php>

1. Problemet në Komunën e Shtimes

Mungesa e stacioneve të autobusëve, kapacitetet e pamjaftueshme të shërbimit të zjarrfikësve, mungesa e ndriçimit publik, prezenca e shtuar e gurëthyeseve nëpër fshatra, mosmirëmbajtja e lumit të qytetit, mungesa e parkingjeve të rregulluara për vetura, janë disa nga problemet më të cilat aktualisht përballen qytetarët e Shtimes.

Komuna e Shtimes nuk ka investuar në rregullimin e vend ndalimit të autobusëve dhe rrjedhimisht nga kjo udhëtarët presin autobusët lokal vend e pa vend. Kjo i detyron udhëtarët që të presin autobusët në ambient të hapur edhe nën kushte të këqija atmosferike.

Mungesa e kapaciteteve të Qendrës së Zjarrfikëseve në Shtime e pamundëson intervenimin e shpejtë dhe efikas të zjarrfikëseve në fikjen e zjarreve. Së fundmi, Komuna e Shtimes ka fituar si donacion një automjet për fikjen e zjarreve i cili është edhe automjeti i vetëm që kjo komunë posedon për këtë lloj intervenimi.

Komuna e Shtimes ka afërsisht dy vite që ndriçimin publik në qendrën e qytetit e ka transferuar me panela solare, por kjo nuk është treguar gjithaq efikase për shkak se në shumicën e shtyllave të ndriçimit këto panela nuk japin ndriçim gjatë natës. Ndriçimi publik mungon edhe në shumë zona të tjera të qytetit. Kjo është përcjellë me adresime të shpeshta të banorëve të lagjeve dhe zonave të qytetit të cilët kanë kërkuar nga autoritetet lokale marrjen e masave për zgjerimin e ndriçimit publik.

Wshtrw rregulluar shtrati i lumit që përshkon qytetin, por mos mirëmbajtja ka shkaktuar shndërrimin e tij në hapësirë për hedhjen e mbeturinave. Kjo ka ndikuar negativisht edhe në pamjen e përgjithshme të qytetit.

Problematike në Komunën e Shtimes ka rezultuar të jetë edhe mungesa e parkingjeve për ndaljen e veturave. Kjo përcillet me ndalimin e tyre në trotuare dhe në vendet e tjera ku vështirësohet lëvizja e qytetarëve.

2. Performanca buxhetore e Komunës së Shtimes

Komuna e Shtimes, është komuna e cila ka me së paku të hyra nga të gjitha komunat e vendit, përjashtuar këtu komunat të cilat janë formuar së voni nga procesi i decentralizimit në vend. Të hyrat vjetore të Komunës së Shtimes sillen rreth 350.000 euro dhe të përafërta me ato të Hanit të Elezit (300.000 euro) apo të Shtimes (250.000), edhe pse këto dy komuna kanë shumë më pak banorë.

Tabela nr.1: Shkalla e të hyrave komunale në katër vitet e fundit

VITI	2012	2011	2010	2009
Shuma (euro)	271.819	372.511	310.623	240.000

Nga tabela e mësipërme vërehet së dallimi mes të hyrave nga viti 2011 krahasuar me atë 2010, dallon për 61.888 euro më shumë në vitin 2011. Por, krahasimi mes të hyrave të vitit 2011 dhe atij 2012 tregon për një rënie prej mbi 100.000 eurosh. Kjo paraqet një rënie drastike të të hyrave komunale.

Tabela nr.2: Buxheti i përgjithshëm i Komunës së Shtimes për vitin 2013

Kategoria	Shuma (euro)
Investime kapitale	1.081.453
Mallra dhe shërbime	476.264
Subvencione	67.914
Shpenzime komunale	120.350
Paga dhe mëditje	3.020.586
Gjithsej	4.786.567

Shuma totale e buxhetit të Komunës së Shtimes për vitin 2011 ka qenë 4.251.781 euro, kurse buxheti për vitin 2012 kap shumën 4.713.956 euro. Nga tabela e mësipërme vërehet një rritje krejtësisht simbolike e buxhetit për vitin 2013. Po ashtu nga vlerësimet e mësipërme vërehet se shuma që Komuna e Shtimes dedikon në linjën e mallrave dhe shërbimeve është e përafërt me shumën totale të të hyrave komunale gjatë një viti. Në vitin 2011 shuma e përgjithshme e të hyrave ka qenë 372.511 euro, ndërsa për kategorinë e mallrave dhe shërbimeve janë dedikuar 357.058 euro. Për këtë vit (2013) shuma që është paraparë për kategorinë e mallrave dhe shërbimeve është 476.264 euro.

Tabela nr.3: Shpenzimet për dreka dhe darka zyrtare të Komunës së Shtimes 2011.⁶

Drejtoritë	Shuma (Euro)
Zyra e Kryetarit	9.290,50
Administrata e Përgjithshme	2.086,50
Inspeksioni	295,00
Arsimi	2.160,00
Zhvillimi Rural	150
Pylltaria	170,00
Planifikimi Urban	190,00
Shëndetësia	325,00

⁶ Komuna e Shtimes. Raporti financiar janar – dhjetor 2011.

ZLK	463.00
Zyra e Kuvendit Komunal	3.105.00
QKMF	1.650.00
Shkollat (fillore dhe mesëm)	2.855,35
Gjithsej	22.740,35

Tabela nr.4: Shpenzimet për telefoni fikse të Komunës së Shtimes 2011.⁷

Drejtoritë	Shpenzimet për telefon mobil (euro) ⁸	Shpenzimet për telefon fiks (euro)
Administrata e Përgjithshme	2.413,65	3.213,74
Zjarrfikësit	240	172,78
QKMF	120	589,48
Shkollat (fillore dhe mesëm)	1.040	2.435,32
Shërbimet sociale	240	426,09
Zyra e Kryetarit	2.071,81	-
Inspekcioni	720	-
Buxhet dhe financa	240	-
Shëndetësia	240	-
Arsimi	240	-
Planifikimi urban	240	-
ZLK	240	-
Menaxhimi i katastrofave natyrore	270	-
Zhvillimi rural	130	-
Pylltaria	120	-
Gjithsej	8.805,46	6.837,41

⁷ Komuna e Shtimes. Raporti financiar janar – dhjetor 2011. Pasqyrimi i shumave fikse në tabelën nr.4: ka ardhur duke ju referuar shpenzimeve të detajuara të dërguara nga Komuna e Shtimes në adresë të Institutit.

⁸ Komuna e Shtimes. Raporti financiar janar – dhjetor 2011.

Tabela nr.5: Shpenzimet në disa kategori në linjën për mallra dhe shërbime në Komunën e Shtimes për vitin 2012

Kategoria	Shuma (euro)
Shpenzime në telefonin mobile	10.361
Shpenzimet në telefonin fikse	5.778
Lëndë djegëse (naftë, derivate, dru)	144.624
Dreka zyrtare	22.548
Mirëmbajtje te objekteve, veturave dhe pajisjeve	77.313
Shpenzimet e marketingut	9.256

3. Investimet kapitale

Investimet kapitale në Komunën e Shtimes gjatë viteve 2010 - 2011 kanë pasur një shtrirje të gjerë duke përfshirë rregullimin dhe asfaltimin e rrugëve, rrjetit të kanalizimit, dhe objekteve tjera përcjellëse në sferën e arsimit dhe atë të shëndetësisë. Shuma e përgjithshme e mjeteve që ka Komuna e Shtimes në dispozicion për investime kapitale gjatë një viti është afro një milionë euro.

Tabelën nr.6: Disa nga investimet kapitale të Komunës së Shtimes të realizuara gjatë vitit 2011

Projektet kryesore të realizuara gjatë 2011 dhe 2012	Shuma (euro)
Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Rashincë (faza e parë)	60.000
Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Muzeqinë (faza e parë)	60.000
Ndërtimi i rrjetit primar të kanalizimit për fshatrat Gjurkocv, Godanc i Ulët, Godanc i Epërm dhe Lagje e Pajtimit (faza e parë)	64.000
Asfaltimet e rrugëve dhe kanalizimet në Vojnovc	80.000
Ndërtimi i fushës së futbollit në Shtime	30.000
Ndërtimi i Çerdhes së fëmijëve (faza e parë)	40.000
Rregullimi i trotuareve në Muzeqinë - Shtime dhe Carralevë	80.000
Asfaltimi i rrugës në brendësi të fshatit Petrovë	100.000
Projekte të infrastrukturës me participim	190.000
Blerja e automjetit për Qendrën e Shërbimeve Sociale	10.000
Ndërtimi i fushës sportive në Shkollën fillore në Davidoc	11.000
Ndërtimi i fushës sportive në Shkollën fillore në Pjetërshticë	11.000
Ndërtimi i fushës sportive në Shkollën fillore në Muzeqinë	11.000
Ndërtimi i fushës sportive dhe rrethoja në Shkollën fillore në Rashincë	19.000

Riparimi i shkollës fillore në Belincë	13.314
Riparimi i kulmit të shkollës fillore në Zborc	14.447
Projektet kryesore të realizuara gjatë 2010	Shuma (euro)
Asfaltimi i rrugës “Babush i Muhaxhirëve”	239.629,69
Asfaltimi i rrugës në relacionin Banull – Shalë	93.529,40
Asfaltimi i rruges për në Blinaj	110.147,30
Asfaltimi i rrugës për në fshatin Brus	35.532
Instalimi i kanalizimit në Livazhd	73.630
Shtrirja e rrjetit të kanalizimit në Shalë	239.218
Rrjeti i kanalizimit në relacionin Ribar - Zhllakuqa	175.839,57
Rrjeti i kanalizimit në Podurovc	95.694
Faza e parë e instalimit të rrjetit të kanalizimit në Sllovi	91.834
Asfaltimi i rrugës në Grack të vogel	188.888
Asfaltimi i rrugës në Kojskë	130.885,10
Asfaltimi i rrugës Rufc i vjetër	466.612,27
Asfaltimi i rrugës “Avdi Kelmendi”	50.846,35

Një nga projektet më të mëdha të proklamuar për Komunën e Shtimes ka qene ai për ndërtimin e parkut te biznesit ne këtë qytet. Komuna kishte ndarë 10.7 hektarë tokë të pronës komunale për një investim të premtuar nga Sllovenia për një park teknologjik. Me gjithë punën e rrafshimit të terrenit, dy herë përrurime të projektit (gur themeli i parë në qershor 2007 nga Kryeministri Çeku, i dyti në prill 2008 nga Kryeministri Thaçi), premtimi për 25 objekte, 9 biznese sllovene dhe 500 vende të reja pune asnjëherë nuk u realizua sepse projekti ka dështuar në tërësi. Komuna e Shtimes se voni ka anuluar vendimin për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale për ndërtimin e parkut teknologjik “Tehnopolis” me arsyetimin se firma sllovene është tërhequr nga investimi i premtuar.

4. Aktivitetet e Prokurimit Publik 2010 - 2011

Për dy vite (2010-2011) Komuna e Shtimes ka lidhur 173 kontrata nëpërmjet procedurave të prokurimit publikë, me një vlerë prej mbi 3.800.000 euro. Organi i prokurimit në Komunën e Shtimes funksionin në nivel të Zyrës së Prokurimit dhe ka dy të punësuar.

Tabela nr.7: Kontratat e Prokurimit në Komunën e Shtimes
2010-2011

Viti	Nr. i kontratave	Vlera e kontratave
2010	92	1.797.886,71
2011	81	2.030.637,77
2012	52	2.175.367,16
Totali	225	6.003.891,64

Sqarim: Për vitin 2012 të dhënat janë vetëm njoftimet e dërguara në KRPP

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) ka gjetur disa raste kur autoritetet e prokurimit në Komunën e Shtimes nuk i kanë përfillur procedurat e tenderimeve, për çka OSHP ka nxjerrë vendime për përsëritjen e procedurave të prokurimit. Rasti i parë i kësaj natyre ka të bëjë me prerjen e druve për furnizim të shkollave.⁹

Në raportin e punës së Kryetarit të Komunës së Shtimes për vitin 2012 askund nuk përmenden aktivitetet e Zyrës së Prokurimit, numri i tenderëve të shpallur dhe shuma totale e kontraktuar. I vetmi organ komunal i cili nuk është përfshi në këtë raport është Zyra e Prokurimit si dhe Zyra e Auditorit të Brendshëm, ndonëse këto paraqiten si nder zyret më me rëndësi në nivel institucioni.

5. Administrata e Komunës së Shtimes

Numri i përgjithshëm i të punësuarve në Komunën e Shtimes është 168 duke mos përfshirë këtu edhe të punësuarit në sektorin e arsimit. Së bashku me këtë sektorë numri i përgjithshëm i të punësuarve në Shtime është 646 gjithsej të punësuar.

Auditori i Përgjithshëm i vendit në raportin e fundit i cili i referohet periudhës së 2011 ka hasur në parregullsi në dosjet e personelit të Komunës së Shtimes ku mungojnë dokumente si formulari i aplikimit, vlerësimi i intervistës së rekrutimit, përshkrimi i punës, raporti i vlerësimit të punës së bërë në fund të vitit (për të gjithë punëtorët), vlerësimi i nevojave për trajnime, format e pushimit vjetor, si dhe format për mungesat në punë.¹⁰

⁹ Organi Shqyrtues i Prokurimit. Njoftimet e shpallura. Burimi: http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2010/furnz_drupreje_korrik10.pdf

¹⁰ Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Raporti i Auditorit të Përgjithshëm për Komunën e Shtimes 2011. Burimi: <http://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?LID=2>

Tabela nr.8: Numri i të punësuarve sipas sektorëve në Komunën e Shtimes

Sektorët	Numri i të punësuarve
Zyra e Kryetarit	8
Drejtoria e Administratës	21
Drejtoria e Bujqësisë	5
Drejtoria për Ekonomi dhe Financa	12
Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi	9
Drejtoria e Shërbimeve publike	9
Drejtoria për Arsim, Kulturë dhe Rini	7
Drejtoria e Shëndetësisë	1
Zyra Komunale për Komunitete	3
Auditori i Brendshëm	1
Zjarrfikësit	8
Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare	74
Qendra për Punë Sociale (QPS)	10
Gjithsej	168

Shkalla e përfaqësimit të femrës mbetet tejet e vogël. Nga 86 të punësuar në Komunë të Shtimes 27 janë femra, ndërsa 59 janë meshkuj. Nga kjo del që Komuna e Shtimes ka 31% të punësuar femra, numër ky relativisht i kënaqshëm i punësimit të femrave, krahasuar me komunat tjera të vendit. Nga tabela po ashtu bie në sy që Drejtoria e Shëndetësisë rezulton ta ketë vetëm një të punësuar, përkatësisht Drejtorin, ndërsa Zyra për komunitete ka tre të punësuar.

6. Arsimi në Komunën e Shtimes

Në Komunën e Shtimes funksionojnë gjithsej 20 shkolla fillore (objekte shkollore), një shkollë e mesme dhe një çerdhe publike. Komuna e Shtimes numëron 427 fëmijë të inkuadruar në sistemin e arsimit para fillor kurse në arsimin e ulët 5.517 nxënës ku 2.878 janë meshkuj dhe 2.639 janë femra. Në Komunën e Shtimes ekziston vetëm një shkolla e mesme.

Tabela nr.9: Numri i mësimitdhënësve dhe stafit përcjellës në 20 shkollat fillore të Shtimes:

Gjinia	Shkolla fillore		Shkolla të mesme	
	Numri i mësimitdhënësve	Stafi ndihmës	Numri i mësimitdhënësve	Stafi ndihmës
Femra	128	1	30	0
Meshkuj	190	58	61	10
Gjithsej	318	59	91	10

Tabela nr.10: Numri total i mësimdhënësve, nxënësve dhe stafit ndihmës në 20 shkolla fillore dhe një shkollë të mesme në Komunën e Shtimes

Kategoria	Numri	F	M
Mësimdhënës	409	158	251
Nxënës	7.237	3.412	3.825
Stafi ndihmës	69	1	68

Një dukuri që vërehet në komunën e Shtimes është braktisja e shkollës nga nxënësit. Gjatë viti shkollor 2011/2012 në shkollat fillore dhe të mesme e kanë braktisur shkollën gjithsej 70 nxënës. Në shkollën e mesme "Emin Duraku" në Shtime gjatë vitit 2010 -2011 e kanë braktisur shkollën 62 nxënës, prej tyre 17 femra.

Në Komunën e Shtimes gjatë dy viteve të kaluara është shënuar përparim në përmirësimin e infrastrukturës në objektet arsimore. Shkollat përgjithësisht janë gëlqerosur, janë ndërtuar salla të sporteve dhe investime ka pasur edhe në ambientet e jashtme. Po ashtu janë ndërtuar dhe funksionalizuar dy shkolla të reja dhe një çerdhe. Çerdhja është ndërtuar në qendër të qytetit, po ashtu edhe shkolla "Emin Duraku", ndërsa një shkollë fillore në fshatin Baincë. Shkollat kanë qenë të ndërtuara në partneritet mes Komunës së Shtimes dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.¹¹

Tabela nr.11: Disa nga investimet gjatë 2010-2012 në infrastrukturën e shkollave të Shtimes:

Investimet	Shuma (euro)
Ndërtimi i fushës sportive në Shkollën fillore në Davidoc	11.000
Ndërtimi i fushës sportive në Shkollën fillore në Pjetërshticë	11.000
Ndërtimi i fushës sportive në Shkollën fillore në Muzeqinë	11.000
Ndërtimi i fushës sportive dhe rrethoja në Shkollën fillore në Rashincë	19.000
Riparimi i shkollës fillore në Belincë	13.314
Riparimi i kulmit të shkollës fillore në Zborc	14.447
Riparimi i shkollës fillore "Emin Duraku" në Shtime	10.000
Blerja dhe montimi i kalldajave për shkollat në: Godanc, Zborc, Reçak, Davidoc dhe Pjetërshticë	20.000
Rregullimi i kopshteve në oborret e shkollave: Muzeqinë, Gjurkoc, Mollopolc, Reçak, Shtime dhe Carralevë	119.966
Riparimi i SHM "Naim Frashëri" në Shtime	10.000
Ndërtimi i fushës sportive në SHM "Naim Frashëri" në Shtime	14.530

¹¹ Komuna e Shtimes. Ueb faqja Zyrtare. Tabela e njoftimeve. Burimi: <http://www.shtime-komuna.org/?mod=news&newsid=1359&id=1>

7. Shëndetësia në Komunën e Shtimes

Në Komunën e Shtimes funksionon Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) si dhe tri qendra të tjera të mjekësisë familjare në fshatrat Pjetërshicë, Muzeqinë dhe Petrovë. Totali i të punësuarve në sektorin e shëndetësisë në Komunën e Shtimes është 74 të punësuar.

Tabela nr.12: Numri dhe pozitat e të punësuarave në QKMF të Shtimes

Pozitat	Numri
Mjek përgjithshëm	16
Specialistë	2
Pulmolog	1
Gjinekolog	1
Dentist	2
Radiolog	1
Infermier	30
Laboranta	5
Staf ndihmës / administratë, pastrim, arkivim, vozitës.	16
Gjithsej	74

8. Transparenca

Zyra për Informim në komunën e Shtimes funksionon brenda Zyrës së Administratës dhe ka dy të punësuar. Kjo komunë mbulohet rrallë nga mediumet e shkruara dhe ato elektronike. Madje mediet nacionale nuk kanë as korrespondent nga ky lokalitet. Korrespondentët e Ferizajt kohe pas kohe i mbulojnë zhvillimet nga Komuna e Shtimes. Në Shtime ekziston një radio lokale, por kapacitetet e saj financiare dhe humane janë të kufizuara.

Komuna e Shtimes, njëherazi ka të hapura dhe i mirëmban dy faqe zyrtare. Informatat që plasohen në këto ueb faqe janë sipërfaqësore dhe të pakta. Në asnjërën faqe nuk mund të gjendet qoftë edhe një raport i cili tregon për shpenzimet komunale.

Tabela: nr.13: Vlerësim i përmbajtjes së ueb faqes së Komunës së Shtimes¹²

<http://kk.rks-gov.net/shtime/Home.aspx>

Dokumenti	2010				2011				2012			
	I	II	III	IV	I	II	III	IV	I	II	III	IV
Raporti i Punës së Kryetarit	x	x	x	x	x	x	x	x	√	x	X	x
Raporti financiar (buxhetor) i Komunës	x	x	√	x	x	x	x	√	x	x	X	x
Raportet e Drejtorisë së Administratës	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Raportet e Drejtorisë së Arsimit	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Raportet e Drejtorisë së Shëndetësisë	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Raportet e Drejtorisë së Inspektionit	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Ekonomi dhe Zhvillim	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Gjeodezi dhe Kadastër	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Buxhet dhe Financa	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Mbrojtje dhe Shpëtim	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Planifikim dhe Urbanizëm	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Shërbimet Publike	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Kulturë, Rini dhe Sport	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Raportet dhe njoftimet e Zyrës së Prokurimit	√				√				√			
Raportet e Njesisë së Auditimit të Brendshëm	x				x				x			
Procesverbalet e Kuvendit Komunal	x				x				x			
Rregulloret Komunale	x				x				x			
Vendimet e Kuvendit Komunal	√				x				x			
Rregullorja e Punës së Kuvendit Komunal	x											
Procesverbalet e Komitetit për Politikë dhe Financa	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Planet dhe Strategjitë e Komunës	√											

X = mungon raporti.

√ = raporti është i publikuar në ueb-faqe.

¹² Tabela nr.13: Pasqyron përmbajtjen e ueb faqes zyrtare të Komunës së Shtimes e hapur sipas modelit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit lokale dhe jo përmbajtjen e ueb faqes së hapur nga vetë komuna.

9. Përmbushja e premtimeve të fushatës zgjedhore 2009

Gjatë fushatës zgjedhore 2009 kandidati për kryetar komune, tani Kryetari i Komunës z. Naim Ismajli, para elektoratit të tij ka prezantuar 19 premtime për sfera të ndryshme. Pas monitorimit të të gjitha premtimeve të dala nga fushata zgjedhore, Instituti GAP dhe BIRN, në fund të 2010 i kanë shkruar letër të hapur Kryetarit të Komunës të cilit ia përkujtuan edhe një herë premtimet e dhëna, duke kërkuar njëkohësisht realizimin e tyre.

Tabela më poshtë vlerëson progresin e arritur në realizueshmërinë e premtimeve të dhëna më 2009. Në

këtë tabelë janë përfshirë 19 premtime të dhëna. Në bazë të hulumtimit të GAP del se pas dy viteve të qeverisjes në komunën e Shtimes, apo gjysmën e mandatit qeverisës, 5 premtime janë përmbushur, 5 nuk janë realizuar, ndërsa në 9 premtim ka pasur nisma dhe rezultate evidente, por nuk mund të konsiderohen premtime të përmbushura:

Premtimet	Realizueshmëria
Zhvillim ekonomik dhe përkrahje në bujqësi, veçanërisht mbështetje të fermerëve përmes subvencionimit nga komuna dhe qeveria	Subvencionimet janë realizuar kryesisht nga programi i MBZHR (Qeveria), por te koordinuara dhe të lehtësuara edhe nga ana e autoriteteve komunale në Shtime.
Zhvillim rural dhe turizëm	Komuna është përpjekur të krijoj lehtësira në këtë fushë. Gjatë vitit 2012 janë shpërndarë disa makina mjelëse, është ndihmuar dhe koordinuar fushata e korje shirjeve si dhe janë organizuar disa panair që për fokus kanë pasur zhvillimin e sektorit të bujqësisë në përgjithësi.
Përkrahje për arsimin, kulturën, rininë dhe sportin	Premtim përgjithësisht i përmbushur, ndonëse disa klube kanë shuar veprimtarin e tyre gjatë periudhës së fundit.
Shëndetësi dhe mirëqenie sociale më të mirë	Gjendje në shëndetësi është e njëjtë me kohën e para zgjedhjeve lokale.
Ambient më të pastër	Janë ndërtuar parqe në 3 fshatra me donacion të USAID, por parqet nuk janë mirëmbajtur dhe për pasojë demtimi i tyre ka qenë sistematik.

Ndërtimin e një minihidrocentrali	Asnjëherë nuk është punuar në këtë drejtim, por Komuna ka komunikim me një kompani gjermane, e cila ka bërë studim fizibiliteti që nga 2004 dhe aktualisht është e interesuar për ndërtimin e një centrali për prodhim të energjisë elektrike nga era.
Investime në fshatin Belincë, ndërtimin e rrugës dhe të kanalizimit, si dhe ndërtimin e shkollës së re	Janë kryer rruga dhe kanalizimi.
Për fshatin Zborc: ujësjellësin, asfaltimin e rrugëve të mbetura dhe një fushë sportive	Premtim i përmbushur.
Për fshatin Reçak asfaltimin e çdo rrugice dhe vendosjen e kanalizimit	Premtim i përmbushur.
Për fshatin Petrovë, ndërtimin e shkollës së re me sallë të edukatës fizike, ndërtimin e urës së re, trotuarin përgjatë rrugës kryesore, një terren sportive, rregullimin e kanalizimit, ndërtimin e administratës për shërbime administrative dhe ujësjellësin i cili do të ketë edhe një burim alternative në Grykë të Topillës.	Janë kryer trotuari, ura, terreni sportiv, ujësjellësi (jo me burimin nga Gryka e Topillës), ndërsa nuk është kryer shkolla.
Për fshatin Vojnovcë: kanalizimin, asfaltimin e rrugëve dhe rrugicave , rregullimin e shtratit të lumit si dhe ndërtimin e një shkolle	Janë kryer kanalizimi dhe asfalti, shtrati i lumit në punim, shkolla jo.
Për fshatin Muzeqinë: ndërtimin e një rezervuari për furnizim me ujë të pijshëm, ndërtimin e një shkollë të re, asfaltimin e rrugicave, rregullimin e kanalizimit dhe një zyre administrative;	Rrugicat janë asfaltuar, zyra administrative duke u punuar, kanalizimi dhe trotuari janë kryer, ndërsa jo shkolla dhe rezervuari.
fshatin Gjurkovc: ndërtimin e një objekti të ri shkollor dhe kanalizimin e fshati	kanalizimi ka nisur, shkolla jo.
Për fshatin Godanc: kanalizimin dhe rrugë të asfaltuara në çdo lagje ku do të kaloj autoudha, e cila do të jetë nje lidhëse për te	Kanalizimi ka filluar, është duke u punuar në disa rrugë.

fshatin Mollopolc: asfaltimin e të gjitha rrugëve të fshatit, shtrirjen e rrjetit të ujësjellësit, kanalizimin për ujërat e zeza, rregullimin e një terreni sportiv, subvencionim të fermerëve	Janë kryer rrugët dhe terreni sportiv, ujësjellësi dhe kanalizimi jo.
Përfundimin e Kompleksit Përkujtimor të Recakut	Është punuar në disa faza, me investime nga Qeveria dhe Komuna, dhe është afër përfundimi i përgjithshëm i projektit.
Pastrimin dhe zgjerimin e lumit nga Carraleva deri në Mollopoc	Nuk është kryer.
Kanalizimi i fshatit në Davidovc	Pjesë më e madhe e fshatit ka ujësjellësin.
Avancimin e femrës në punësim dhe shkollim	Premtim i papërbushur.

10. Burimet:

1. Komuna e Shtimes. Raporti financiar janar – dhjetor 2011
2. Komuna e Shtimes. Raporti i të punësuarve në administratën komunale
3. Komuna e Shtimes. Raporti i të punësuarve në QKMF
4. Zyra e Auditorit të përgjithshëm. Raporti i Auditorit për Komunën e Shtimes për vitin 2011. Burimi:
http://www.oagrks.org/repository/docs/Shtime_31_12_2011_Final_alb_222045.pdf
5. Ueb faqja zyrtare e Komunës së Shtimes. <http://kk.rks-gov.net/shtime/Home.aspx>
6. Tabelat e Buxhetit të Qeverisë së Kosovës për vitin 2011. <http://mf.rks-gov.net/sql/ministriaefinancave/buxhetiirepublikessekosoves/buxhetiqaendror e.aspx>
7. Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë. Statistikat e Arsimit në Kosovë 2011. Statistikat e arsimit në Kosovë. Burimi: <http://www.masht-gov.net/advCms/documents/11052012.pdf>
8. Raportet vjetore 2010 -2011 të Koomisionit Rregullativ të Prokurimit Publik - http://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Home&LID=1&PCID=-1&CtlID=HTMLStatic&CID=PPRCannual&PPRCMenu_OpenNode=90
9. Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Njoftimet për lidhjen e kontratave përmes prokurimit publik nga Komuna e Shtimes. - https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=SearchNotices&stat=2&PPRCMenu_OpenNode=114
10. Organi Shqyrtues i Prokurimit. Njoftimet e shpallura për Komunen e Shtimes. http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2010/furnz_drupreje_korrik10.pdf
11. Agjencia e Statistikave të Kosovës. Rezultatet përfundimtare për Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave - 2011. Burimi: http://esk.rks-gov.net/rekos2011/repository/docs/Te%20dhenat%20kryesore_ALB.pdf